

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 703 Prot.

Tiranë, më 27.10 2015

**VENDIM Nr. 105, datë 21.10.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, të datës 21.10.2015, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i ujësjellësit Fushë Kuqe-Durrës dhe rrjeti i kanalizimeve në zonën Ura e Dajlanit-Plepa Durrës", Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" Sh.P.K.,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i ujësjellësit Fushë Kuqe-Durrës dhe rrjeti i kanalizimeve në zonën Ura e Dajlanit-Plepa Durrës", Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" Sh.P.K.
- II. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime (DPUK), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk mund të fillojë punimet pa kontraktuar *me shoqërinë arkeologjike të licencuar*, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit të projektit në qytetin e Durrësit, dokumentacionin e të cilit duhet ta depozitojë pranë ASHA. DPUK duhet të lidhë paraprakisht kontratë tre palëshe *me shoqërinë arkeologjike të licencuar* dhe *Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik*, e cila do të realizojë mbikqyrjen e shoqërisë arkeologjike, nëpërmjet dokumentacionit të depozituar nga ana e saj dhe kontrolleve në terren.
- III. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**